

VENDIM
Nr. 14, datë 21.6.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Altin Binaj	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Elsa Toska	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 21.6.2022 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh çështjen nr. 1 (F) 2022 të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Fatjon Kapri

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2021-315, datë 18.5.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Papërdorshmëria e vendimit nr. 223, datë 23.12.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, si një akt i marrë në kundërshtim me nenet 12, 13, 128, pika 1, shkronja “a”, të Kodit të Procedurës Penale.

Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

SUBJEKT I INTERESUAR:

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, pika 1, 5, 15, 17, 18, 21, 29, pika 2, 32, pikat 1 dhe 2, 33, 38, pika 1, 42, pikat 1 dhe 2, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6, 7 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; neni 27 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Elsa Toska, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuari është akuzuar për kryerjen e vrasjes së shtetasit shqiptar Y.P., që ka ndodhur në datën 7.4.2001 në Londër në Mbretërinë e Bashkuar. Duke qenë se pas kërkimeve të kryera nga policia angleze ka rezultuar se ai ishte larguar nga Mbretëria e Bashkuar, autoritetet ligjzbatuese angleze kanë kërkuar ndihmën e shtetit shqiptar për hetimin dhe gjykimin e kësaj ngjarjeje, duke i dërguar edhe aktet përkatëse. Prokuroria shqiptare, bazuar në parimin e zbatimit të ligjit penal për veprat penale të kryera nga shtetasit shqiptarë në territorin e një shteti tjetër, pas kryerjes së hetimeve, në bashkëpunim me autoritetet angleze, ka vendosur të shpallë mosgjyqjen e kërkuarit dhe ta çojë

çështjen për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, duke e akuzuar atë për kryerjen e veprës penale “Vrasje me paramendim”, të parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal (KP).

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan e ka gjykuar kërkuesin në mungesë, ku ai është mbrojtur nga avokati I.D., i caktuar kryesisht nga gjykata. Në përfundim të gjykimit, pas marrjes dhe administrimit të provave nga Mbretëria e Bashkuar, me vendimin nr. 223, datë 23.12.2002, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan e ka deklaruar kërkuesin fajtor për kryerjen e veprës penale “Vrasje me paramendim”, të parashikuar nga neni 78 i KP-së dhe bazuar në nenin 50/a të KP-së e ka dënuar me 22 vjet burgim.

3. Ky vendim është ekzekutuar në datën 18.9.2015 kur kërkuesi është ekstraduar nga Mbretëria e Bashkuar. Në datën 28.9.2015 ai i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës për të bërë ankim ndaj vendimit nr. 223, datë 23.12.2002 të po asaj gjykate. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 1314, datë 23.2.2016, ka vendosur pranimin e kërkesës.

4. Më pas, kërkuesi ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit Durrës ndaj vendimit nr. 223, datë 23.12.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, duke parashtruar një sërë pretendimesh për shkelje procedurale në marrjen e provave nga ana e gjykatës së shkallës së parë.

5. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 606, datë 26.7.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 223, datë 23.12.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Ndaj këtij vendimi ka bërë rekurs kërkuesi.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2021-315, datë 18.5.2021, ka vendosur mospranimin e rekursit. Në arsyetimin e vendimit të saj, Gjykata e Lartë, ndër të tjera, është shprehur se rekursi ishte paraqitur nga një mbrojtës i cili nuk e kishte tagrin e dhënë në mënyrë të shprehur nga kërkuesi për ta ushtruar atë në Gjykatën e Lartë. Sipas saj *“rekursi është paraqitur dhe nënshkruar nga avokati Bajram Stafa, i cili është legjitimuar me deklaram në seancën gjyqësore në Gjykatën e Apelit Durrës nga i gjykuari, ndërsa nuk rezulton që mbrojtësi të ketë marrë në mënyrë të shprehur tagrin për të ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë (...) mbrojtësi i zgjedhur me deklaram në seancë gjyqësore nuk legjitimohet të bëjë rekurs për aq kohë sa kjo tagër nuk i jepet në mënyrë të shprehur nga i pandehuri apo i gjykuari”*. Gjithashtu, Gjykata e Lartë, duke iu referuar themelit të çështjes dhe shkaqeve të rekursit, ka vlerësuar se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP) për cenimin e vendimmarrjes së gjykatave më të ulëta.

7. Në datën 26.1.2022 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 00-2021-315, datë 18.5.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, përdorshmërinë e vendimit nr. 223, datë 23.12.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe kthimin e çështjes për rigjykim në këtë të fundit.

8. Kolegji i Gjykatës, i mbledhur në datën 24.3.2022, ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Mbledhja e Gjyqtarëve në datën 11.4.2022 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazën e dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, pretendon se janë cenuar:

9.1 *E drejta e aksesit në gjykim*, pasi Gjykata e Lartë ka gabuar në arsyetimin që ka bërë në lidhje me tagrat e përfaqësimit të mbrojtësit të tij. Ky i fundit e ka pasur tagrin për të bërë rekurs, i cili buronte nga akti i përfaqësimit i datës 25.9.2016.

9.2 *Gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi vendimi në gjykatën e shkallës së parë është marrë vetëm nga një gjyqtar, në kundërshtim me nenin 78 të KP-së, ku parashikohet se një dënim

maksimal me 25 vjet burgim jepet nga një trup gjykues i përbërë nga tre gjyqtarë. Për pasojë, vendimi nr. 223, datë 23.12.2002 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është i papërdorshëm dhe absolutisht i pavlefshëm, pasi gjyqtarët e tjerë Q.H. dhe R.M. nuk e kanë nënshkruar atë. Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit nuk janë treguar të paanshme, duke fshehur provat dhe prokurën e caktimit të avokatit për të legjitimuar një proces gjyqësor të paligjshëm ndaj kërkuesit.

9.3 *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka përmendur në vendim mjetin me të cilin është kryer vepra, e cila përbën shkak për ndryshimin e cilësimit të veprës penale. Gjithashtu, në vendim mungon arsyetimi për ekzistencën e paramendimit, si element cilësues i veprës penale. Pretendimet e kërkuesit në këtë drejtim nuk janë marrë parasysh nga gjykatat në vendimet e tyre.

9.4 *Parimi i mosdeklarimit fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, për arsye se procesi gjyqësor është bazuar mbi të dhëna të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Sipas kërkuesit, pyetja e dëshmitarit të huaj është bërë në rajonin e policisë, pa e identifikuar atë dhe pa praninë e përkthyesit. Procesi gjyqësor nuk është zhvilluar në gjuhën shqipe në të gjitha fazat e tij. Po kështu, edhe aktet, edhe procesverbalet e transkriptuara dhe të administruara nuk janë të shkruara qartë në gjuhën duke i bërë të palexueshme. Gjyqtari i vetëm i gjykatës së shkallës së parë dhe prokurori, në mungesë të avokatit të kërkuesit, kanë marrë prova jashtë territorit të Shqipërisë, në shkelje të normave procedurale, duke i detyruar të afërmit e kërkuesit të dëshmojnë kundër tij nën presion. Dëshmitë e dëshmitarëve janë marrë në kushtet e takimeve shoqërore, janë manipuluar dhe nuk janë nënshkruar prej tyre.

9.5 *E drejta e mbrojtjes*, pasi ai nuk ka pasur dijeni dhe nuk është njoftuar as nga avokati, as nga gjykata e shkallës së parë se ndaj tij po zhvillohej një proces penal në Shqipëri. Ai nuk është informuar dhe nuk është thirrur nga gjykata për t'u dëgjuar për akuzat në ngarkim të tij. Në gjykimin e çështjes në shkallë të parë kërkuesit i është caktuar kryesisht nga gjykata një avokat pensionist, i paafte për punë, i cili nuk ka bërë një mbrojtje efektive.

9.6 *Parimi i prezumimit të pafajësisë*, për arsye se kërkuesi është prezumuar i fajshëm nëpërmjet një procesi të manipuluar dhe të padrejtë, të pambështetur në prova.

9.7 *E drejta ndërkombëtare*, për shkak se kërkuesi nuk është hetuar dhe gjykuar sipas ligjit penal anglez nga gjykata angleze, e cila është gjykata kompetente në këtë rast, duke qenë se ngjarja ka ndodhur në Mbretërinë e Bashkuar dhe provat janë mbledhur atje. Në Shqipëri nuk ka pasur kallëzim penal ndaj kërkuesit dhe as bazë ligjore për aplikimin e ligjit penal shqiptar. Gjykatat shqiptare e kanë dënuar kërkuesin në mënyrë të padrejtë me një dënim më të rëndë se sa parashikon ligji penal anglez.

9.8 *Parimi i mosdënimit pa ligj*, pasi kërkuesi është gjykuar dhe dënuar për veprën penale “Vrasja”, pa u saktësuar në vendimet gjyqësore se cili është ligji që e parashikon. Ligji me të cilin është dënuar kërkuesi nuk është i njohur për prokurorin, as është përmendur në njoftimin e akuzës në seancën gjyqësore ose t'i jetë njoftuar avokatit mbrojtës të tij. Pasi prokuroria e ka ndryshuar akuzën në “Vrasje me paramendim”, gjykata, në mënyrë të padrejtë, pa riçelur hetimin gjyqësor, pa thirrur dëshmitarët dhe pa u përpjekur për gjetjen e armës së pretenduar të krimit, e ka dënuar kërkuesin me dënimin më të rëndë të parashikuar nga KP-ja.

10. *Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme*, i ka kërkuar Gjykatës rrëzimin e kërkesës, duke argumentuar, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

10.1 Në lidhje me shkakun e parë të mospranimit të rekursit, për moslegjitimitimin e mbrojtësit të kërkuesit, arsyetimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk gjen mbështetje në aktet e gjykimin dhe për këtë arsye pretendimet e kërkuesit në lidhje me këtë arsyetim janë të bazuara.

10.2 Në arsyetimin e tij, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka bërë një vlerësim të shkaqeve të rekursit, duke arritur në përfundimin se ai nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432

të KPP-së. Në arritjen e këtij përfundimi rezulton se ai kolegji nuk ka bërë asnjë arsyetim në lidhje me shkaqet e rekursit. Një qëndrim i tillë bie në kundërshtim me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe për këtë arsye edhe pretendimi i kërkuar për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor është i bazuar.

10.3 Rekursi i paraqitur në Gjykatën e Lartë nga kërkuar nuk është nënshkruar nga mbrojtësi i tij, por vetëm nga kërkuar dhe një mangësi e tillë, sipas nenit 435, pika 2, të KPP-së, sjell mospranimin e rekursit. Për këtë arsye, pavarësisht qëndrimit të mbajtur nga Gjykata e Lartë për shkaqet e mospranimit të rekursit, Gjykata Kushtetuese duhet ta rrëzojë kërkesën e tij.

10.4 Në lidhje me pretendimet e tjera të tij, vërehet se ai nuk i ka shteruar mjetet juridike efektive, për këtë arsye ato nuk mund të merren në shqyrtim nga Gjykata. Për rrjedhojë, nuk është vazhduar me analizën e mëtejshme të pretendimeve të tjera të kërkuar.

III Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitetin e kërkuar

11. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me iniciimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

12. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, pra mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuar të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

13. Për sa më sipër, Gjykata vëren se kërkuar legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

14. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individ i mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim individual kushtetues, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 35, datë 1.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ i t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngrenë në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 12, datë 9.3.2021; nr. 8, datë 19.3.2018; nr. 31, datë 25.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret, Gjykata vëren se pretendimet që lidhen me cenimin e: i. *gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj (paragrafi 9.2)*; ii. *parimit të mosdeklarimit fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme (paragrafi 9.4)*; iii. *parimit të prezumimit të pafajësisë (paragrafi 9.6)*; iv. *së drejtës ndërkombëtare (paragrafi 9.7)*; v. *parimit të mosdënimit pa ligj (paragrafi 9.8)*, kërkuar nuk i ka ngritur në rekursin e tij të paraqitur në Gjykatën e Lartë. Për pasojë, Gjykata vlerëson se ai nuk ka shteruar

mjetet juridike për këto pretendime dhe se pretendimi i subjektit të interesuar në lidhje me to është i bazuar.

16. Në lidhje me pretendimet e tjera të kërkuarit, Gjykata çmon se ai e plotëson kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, pasi nuk ka mjet tjetër ligjor për të shteruar për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese.

17. Për sa i përket legjitimitetit *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, individ, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tij, mund ta paraqesë kërkesën në Gjykatë brenda 4-mujve nga konstatimi i cenimit.

18. Gjykata në jurisprudencën e saj, në rastet e kundërshtimit të vendimeve gjyqësore, ka llogaritur afatin 4-mujor, duke filluar nga data e dhënies së vendimit nga gjykata që ka përfunduar procesin gjyqësor, nëse kërkuari nuk provon në nivel kushtetues se ka marrë dijeni në një datë të ndryshme (*shih vendimet nr. 84, datë 26.12.2017; nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuari ka përfunduar me vendimin nr. 00-2021-315, datë 18.5.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 26.1.2022. Kërkuari pretendon se është në afat për paraqitjen e ankimit të tij, pasi avokati B.S., i cili e ka përfaqësuar atë gjatë gjykimit në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, nuk është interesuar më për çështjen e tij, në mungesë të prokurës për të vijuar me ankimin kushtetues individual në këtë Gjykatë, dhe ai ka marrë dijeni për vendimin e Gjykatës së Lartë në datën 15.12.2021.

20. Ndërkohë, referuar akteve që shoqërojnë kërkesën, Gjykata vëren se në datën 9.12.2021 kërkuari është interesuar vetë për vendimin me anë të një kërkeje drejtuar Gjykatës së Lartë. Kjo e fundit, me anë të shkresës nr. 4681/1, datë 15.12.2021, i ka dërguar kërkuarit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Drenovë një kopje të vendimit, të njëzuar me origjinalin, duke i bërë me dije se vendimi është marrë në datën 18.5.2021. Po kështu, nuk rezulton që avokatit të kërkuarit t'i jetë njoftuar vendimi, edhe pse kishte depozituar të dhënat elektronike për njoftimin e tij. Gjykata e Lartë, me anë të shkresës nr. 1654/1 prot., datë 6.5.2022 të dërguar kësaj Gjykate, ka sqaruar se ajo ka filluar të aplikojë ndryshimet e reja për komunikimin e vendimit në mënyrë elektronike në muajin qershor të vitit 2021, ndërkohë që vendimi për kërkuarin është marrë në datën 18.5.2021.

21. Për sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë faktin se kërkuari është i izoluar për shkak të vuajtjes së dënimit me burgim, rrethanë që e vështirëson të marrë dijeni për vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë nga njoftimi me shpallje, si dhe faktin që avokatit mbrojtës nuk i është komunikuar vendimi elektronikisht edhe pse ka depozituar kontaktet për komunikimin e tij në rekurs, Gjykata arrin në përfundimin se ankimi individual në rastin konkret është paraqitur brenda afatit 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a i ligjit nr. 8577/2000 dhe kërkuari legjitimohet *ratione temporis*¹.

22. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, pretendimet e kërkuarit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes, së drejtës së aksesit dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor hyjnë *prima facie* në juridiksionin kushtetues dhe do të shqyrtohen në vijim nga Gjykata.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së mbrojtjes

23. Kërkuari pretendon se nuk ka pasur dijeni dhe nuk është njoftuar as nga avokati, as nga gjykata e shkallës së parë se ndaj tij po zhvillohej një proces penal në Shqipëri. Sipas tij, ai nuk është thirrur nga gjykata për t'u dëgjuar për akuzat në ngarkim të tij. Gjithashtu, ai pretendon se në gjykimin e çështjes në shkallë të parë i është caktuar kryesisht nga gjykata një avokat pensionist, i paafte për punë, i cili nuk ka bërë një mbrojtje efektive.

¹ Gjyqtarja Fiona Papajorgji votoi kundër legjitimitetit *ratione temporis*

24. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se e drejta e një personi të akuzuar për të qenë i pranishëm në seancën dëgjimore të akuzave të ngritura kundër tij është thelbësore për një proces të drejtë. Kjo përfshin jo vetëm praninë fizike, por edhe aftësinë për të dëgjuar dhe ndjekur procedimet, për të kuptuar provat dhe argumentet, për të orientuar përfaqësuesit ligjorë dhe për të dhënë fakte. Shteti ka detyrimin për ta njoftuar të pandehurin në mënyrë efektive dhe të përshtatshme për seancën, si dhe të marrë masa për të siguruar praninë e tij. Po ashtu, një nga kriteret e gjykimit të drejtë është edhe e drejta e çdokujt, të akuzuar për një veprë penale, për t'u mbrojtur efektivisht nga një mbrojtës ligjor, e drejtë e cila nuk humbet edhe pse personi i akuzuar penalisht nuk ndodhet vetë personalisht në gjyq (*shih vendimet nr. 84, datë 26.12.2017; nr. 40, datë 6.7.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në rastin e gjykimit në mungesë është detyrë e autoriteteve publike që të informojnë të pandehurin nëse ka ose jo një procedim penal në ngarkim të tij, pasi vetëm kështu mund të arrihet siguria se i pandehuri ka hequr dorë me vullnetin e tij të lirë nga pjesëmarrja në gjykim (*shih vendimet nr. 40, datë 6.7.2016; nr. 30, datë 17.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Që e drejta e mbrojtjes të jetë reale dhe efektive, gjykata duhet të marrë të gjitha masat ligjore jo vetëm të sigurojë praninë e mbrojtësit në gjykim, por dhe t'i japë atij mundësinë të bëjë mbrojtje reale duke respektuar barazinë e armëve (*shih vendimet nr. 40, datë 6.7.2016; nr. 10, datë 2.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Pika 2 e nenit 33 të Kushtetutës përcakton se personat që i fshihen drejtësisë humbasin të drejtën për t'u dëgjuar nga gjykata. Në këtë kuptim, Kushtetuta ka ligjëruar gjykimin e të pandehurit në mungesë në rastet kur ai ka marrë dijeni se ndaj tij ka filluar një proces penal dhe kur ka hequr dorë vullnetarisht nga pjesëmarrja në të (*shih vendimet nr. 84, datë 26.12.2017; nr. 30, datë 17.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, referuar edhe materialeve të dosjes gjyqësore, rezulton se pas kryerjes së procedurave ligjore të bëra nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, kërkuesi ka rezultuar se nuk gjendej. Në këto rrethana nga gjykata i është caktuar një avokat kryesisht. Në procedurën e mosgjethjes, nëna e tij ka deklaruar se është në pamundësi financiare dhe nuk ka pretendime në lidhje me caktimin e avokatit kryesisht. Pas shpalljes në kërkim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 123, datë 3.5.2002, ka vendosur deklarinimin e ikjes së kërkuesit, duke i caktuar atij edhe mbrojtës kryesisht. Më pas, të gjitha njoftimet, si dhe çdo veprim tjetër procedural i bërë nga prokuroria dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan i janë njoftuar mbrojtësit të caktuar kryesisht, i cili rezulton se është njoftuar rregullisht.

27. Gjithashtu, për sa i përket këtij gjykimi, për të cilin kërkuesi pretendon se nuk është njoftuar dhe nuk ka pasur dijeni për zhvillimin e tij, Gjykata vëren se pavarësisht se ka qenë në mungesë dhe është përfaqësuar nga mbrojtësi i caktuar kryesisht, pas kërkesës së tij është rivendosur në afat për të bërë ankim ndaj vendimit të fajësisë të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Pra, me anë të mbrojtësit të zgjedhur nga vetë ai kërkuesi ka ushtruar të drejtën e mbrojtjes dhe ka pasur mundësinë që të gjitha pretendimet në lidhje me vlerësimin e provave dhe fajësinë e tij të shqyrtoheshin nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë, ndaj në këto kushte atij nuk i është cenuar e drejta e mbrojtjes. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit e lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

28. Kërkuesi pretendon se Gjykata e Lartë, duke mos pranuar rekursin si të paraqitur nga një avokat pa tagra ka gabuar në arsyetimin e saj. Sipas kërkuesit, mbrojtësi i tij e kishte tagrin për të bërë rekurs që buronte nga akti i përfaqësimit i datës 25.9.2016. Gjithashtu, ai pretendon se Gjykata e Lartë ka bërë një arsyetim të kufizuar të vendimit të saj.

29. Subjekti i interesuar ka parashtruar se pretendimet e kërkuesit në lidhje me aktin e përfaqësimit dhe cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor janë të bazuara. Megjithatë, sipas këtij subjekti, rekursi i paraqitur në Gjykatën e Lartë nga kërkuesi nuk është nënshkruar nga mbrojtësi i tij, por vetëm nga kërkuesi dhe një mangësi e tillë, sipas nenit 435, pika 2, të KPP-së sjell

mospranimin e tij. Për këtë arsye, pavarësisht qëndrimit të mbajtur nga Gjykata e Lartë në lidhje me shkaqet e mospranimit të rekursit, Gjykata duhet të rrëzojë kërkesën e kërkuarit.

30. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 6, datë 22.2.2022; nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 22, datë 29.4.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 6, datë 22.2.2022; nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se e drejta e ankimit, ashtu si edhe ajo e aksesit në gjykatë, nuk mund t'i cenohen kërkuarit për shkaqe që rrjedhin nga mangësitë ose gabimet në veprimtarinë e vetë organeve shtetërore (*shih vendimet nr. 6, datë 22.2.2022; nr. 5, datë 2.3.2011; nr. 22, datë 26.7.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Për sa i përket gjykimit të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, Gjykata konstaton se kjo e fundit, ndër të tjera, nuk e ka pranuar rekursin e kërkuarit, duke u shprehur se: *“rekursi është paraqitur dhe nënshkruar nga avokati Bajram Stafa, i cili është legjitimuar me deklaram në seancën gjyqësore në Gjykatën e Apelit Durrës nga i gjykuari, ndërsa nuk rezulton që mbrojtësi të ketë marrë në mënyrë të shprehur tagrin për të ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë (...) mbrojtësi i zgjedhur me deklaram në seancë gjyqësore nuk legjitimohet të bëjë rekurs për aq kohë sa kjo tagër nuk i jepet në mënyrë të shprehur nga i pandehuri apo i gjykuari”*.

32. Nga aktet e dosjes gjyqësore Gjykata vëren se kërkuari në seancën e datës 13.7.2016 në Gjykatën e Apelit Durrës ka pranuar me deklaram të mbrohet në gjykim nga avokati B.S. Gjithashtu, pjesë e dosjes gjyqësore në shkallën e dytë të gjykimit është një akt përfaqësimi pa datë, i lëshuar në institucionin e vuajtjes së dënimit, me anë të të cilit kërkuari ka caktuar si avokat mbrojtës shtetasin B.S., duke i dhënë këtij të fundit tagra të bëjë kërkesë për rivendosje në afat, ankim dhe rekurs kundër vendimeve të Gjykatës së Apelit Durrës dhe Gjykatës së Lartë, si dhe ta përfaqësojë atë në shqyrtimin e tyre në këto gjykata. Pra, ndryshe nga sa është shprehur Gjykata e Lartë, Gjykata konstaton se kërkuari i ka dhënë tagrin e përfaqësimit për në Gjykatën e Lartë avokatit të tij B.S.

33. Referuar materialeve që ndodhen në dosjen gjyqësore, Gjykata vëren se rekursi i paraqitur nga kërkuari në Gjykatën e Lartë është nënshkruar nga avokati i tij B.S. dhe prokura e lëshuar nga ai rezulton e administruar, siç u tha më lart, në aktet e dosjes gjyqësore. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i subjektit të interesuar se rekursi nuk është nënshkruar nga mbrojtësi i kërkuarit, sipas përcaktimeve të nenit 435, pika 2, të KPP-së, nuk është i bazuar.

34. Megjithatë, në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë ka vlerësuar edhe themelin e pretendimeve të kërkuarit, duke u shprehur se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së dhe ka vendosur mospranimin e tij. Gjithashtu, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se nuk ka shkaqe për cenimin e vendimmarrjes së gjykatave më të ulëta (*shih paragrafin 34 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

35. Për sa më sipër, Gjykata vëren se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në shqyrtimin e çështjes konkrete, ka vlerësuar pretendimet e ngritura në ankim nga kërkuari, shkaqet e rekursit, si dhe shtesat e saj. Ai kolegji nuk e ka mbështetur arsyetimin e tij vetëm te mospasja e tagrave të përfaqësimit nga ana e mbrojtësit të kërkuarit, por ka vlerësuar edhe shkaqet e rekursit (*shih paragrafët*

17, 26 dhe 34 të vendimit të Gjykatës së Lartë). Për rrjedhojë, Gjykata do të vlerësojë më tej argumentin tjetër të kërkuarit për arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Lartë.

36. Gjykata, bazuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, rithekson se arsyetimi i kufizuar i vendimit të marrë nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit nuk e cenon procesin e rregullt ligjor. Kjo formë arsyetimi shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit. Arsyetimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në dhomë këshillimi, është tregues i faktit se kërkuari nuk ka ngritur asnjë nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës (*shih vendimin nr. 40, datë 6.7.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Në rastin konkret, duke iu referuar vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Gjykata konstaton se në pjesën hyrëse ai përmban palët, bazën ligjore, rrethanat e çështjes, vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, faktin se ka bërë rekurs kërkuari, si dhe shkaqet e tij. Në arsyetimin e saj Gjykata e Lartë është shprehur: *“Pavarësisht sa më sipër, Kolegji vlerëson se edhe referuar themelit, rekursi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i K. Pr. Penale, prandaj në lidhje me të duhet vendosur mospranimi. Kolegji vlerëson se, referuar shkaqeve të rekursit të paraqitur, nuk ka shkaqe për cenimin e vendimmarrjes së gjykatave më të ulëta (paragrafi 34).”*

38. Për sa më sipër, në rastin në shqyrtim, edhe pse Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë duhet të jetë më e kujdesshme, veçanërisht në verifikimin e akteve të përfaqësimit si elemente formale që duhet të plotësohen në paraqitjen e rekursit, ajo, në dhomë këshillimi, ka ushtruar në këtë rast funksionin e saj seleksionues, duke vlerësuar paraprakisht nëse kërkesa i plotësonte kërkesat e ligjit për kalimin në seancë. Edhe pse me një arsyetim të kufizuar, ajo ka parashtruar shkaqet e rekursit dhe i ka vlerësuar ato në përputhje me standardet e mësipërme të arsyetimit në dhomën e këshillimit, duke i dhënë kërkuarit edhe mundësinë e realizimit të aksesit në aspektin formal dhe mbrojtjes efektive, njësoj sikur ajo të ishte bërë nga një avokat.

39. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk cenon standardet e arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit. Për pasojë, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor janë të pabazuara.

40. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuarit janë të pabazuara dhe kërkesa e tij duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 21.6.2022.

Shpallur më 15.7.2022.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Altin Binaj, Elsa Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Fiona Papajorgji